

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqërisë "ALFA-INVEST" Sh.p.k.**

Sot, me datë 15/11/2021,

- **Z. Adrian Masha**, shtetas shqiptare, lindur në Tiranë, më 31/03/1983, banues në Tiranë, mbajtës i kartes se Identitetit me nr. 034179917 me nr. personal. I30331062D, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Z. Ervin Çadri**, shtetas shqiptarë, lindur në Tiranë, më 24/01/1980, banuese në Tiranë, mbajtëse i kartes se Identitetit me nr. 034226211 dhe me nr. personal. I00124143F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ALFA-INVEST" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "ALFA-INVEST" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Vaso Pasha, Pall 13/1 , Ap 14 , Njesia Administrative Nr. 5 Zona Kadastrale 8270 ,Nr psurie 3/106+1-22 Vol 43 , Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.


**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Ushtrimi i aktivitetit privat në fushën e ndërtimeve, ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime publike, ndërtime vepra arti, ndërtim ujësjellsa dhe kanalizime,





- rikonstruksione të të gjitha llojeve, veshje fasadash, mirëmbajtje, projektim të strukturave të zakonshme prej murature, tulla, guri, betonarmeje e metalike, projektim vepra arti etj.
- Prodhim të materialeve inerte, eksport-import e tregti me pakicë e shumicë të artikujve të ndryshëm.
  - Kryerja e veprimtarive të investimit, projektimit, ndërtimtarisë dhe infrastrukturës, tregtisë dhe konsulencës në përgjithësi;
  - Ndërtime publike dhe private, si civile dhe industriale, ndërtesa banimi (edhe vepra të mëdha si qiellgërvishtës etj.) Prishja e kontrolluar me dhe pa lëndë shpërthyes;
  - Punimet civile, industriale, të infrastrukturës në përgjithësi, dhe të të gjitha llojeve, hekurudha, ura, tunele, diga, etj.
  - Ndërtimi i centraleve elektrike të çdo lloji dhe/ose impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
  - Vepra ndërtimore me beton arme, dhe vepra speciale.
  - Rikonstruksioni dhe restaurimi në përgjithësi dhe ndërtesave historike/arkeologjike, sistemimi i shesheve, rikualifikimi urban, hapësirat e gjelbra publike.
  - Zhvillimi Urban – ndërtimet spitalore, shëndetsore dhe të ndihmës sociale.
  - Hotele, turizëm, impiante sportive, fshatra turistike.
  - Projekte për zona të integruara.
  - Punime ndërtimi të rrugëve dhe punime ndihmëse. Vepra autostradale dhe rrugore; Impiante të telekomunikacionit, Ndriçim publik dhe impiante të tjera në përgjithësi.
  - Punime të shpimit të tokës / shpimi për kërkimin e ujit, naftës dhe gazit dhe në përgjithësi si në tokë edhe në det;
  - Veprimtari në shtrimin e tubacioneve në përgjithësi ujësjellsa, tubacione të naftës dhe gazit, pole kimike – aeroporte dhe pistat e aeroporteve, ndërtimi i objekteve ushtarake, bunkere, poligone, etj.
  - Rehabilitime të çdo lloji duke përfshirë lëndët plasëse dhe demilitarizimin.
  - Ndërtimi i landfillleve, pajisja e tyre, ndërtimi i objekteve për kompostimin dhe diferencimin e mbetjeve, vende të grumbullimit të mbetjeve të të gjitha llojeve.
  - Punimet detare (edhe nënujore), porte, limane, punime lumore dhe lagunore;
  - Projektim Arkitektonik dhe Strukturor;
    - o studimet e fizibilitetit,
    - o projekte paraprake, përfundimtare dhe të zbatimit.
  - Raporte vlerësimi;
    - o vlerësime të përshtatshmërisë teknike dhe ekonomike. Studime të ndikimit në mjedis.
    - o inspektime gjeognostike,
    - o variacione plano- rregullatore,
    - o drejtimi i punëve,
    - o kolaudime tekniko-administrative dhe statike.
  - Administrimi i kontratave të prokurimit dhe nënkontraktimi (edhe jashtë vendit), sipërmarrja e punëve dhe e kontratave publike edhe në favor të palëve të treta.
  - Ndërtimi dhe investimi në tregun e pasurive të paluajtshme, kryerja e çdo veprimtarie që lidhet me objektin, në vija të përgjithshme.



- Aktivitete tregtare të cfarëdo natyre dhe lloji, promovimin dhe organizimin e konferencave, seminareve, panairove, trajnimeve në përgjithësi; përgatitjen dhe lëshimin e markave kolektive të cilësisë;
- Mund të përgatisë projekte të çdo lloji në lidhje me çështjet e mësipërme, si vetë ashtu edhe në bashkëpunim me studio apo profesionistë të tretë, qoftë edhe të huaj.
- Blerja, shitja, mbajtja transferimi, dhënia me qira, administrimi i zakonshëm dhe i jashtëzakonshëm i pasurive të paluajtshme të çdo lloji apo natyre, si në Shqipëri dhe jashtë vendit.
- Marrja me qira e makinerive dhe pajisjeve të të gjitha tipeve dhe llojeve;
- Shoqëria mund të angazhohet në aktivitete bujqësore dhe të mbarështimit, veprimtari zooteknike, menaxhimin e tokës dhe të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me bujqësinë;
- Shërbimet financiare dhe të sigurimit;
- Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, nën gjykimin e Organit Administrativ për zbatimin dhe arritjen e objektit të veprimtarisë dhe në masën e lejuar me ligj. Të kryejë operacionet tregtare dhe industriale, financiare, bankare, hipotekuese, ekonomike dhe në lidhje me pasuri të paluajtshme; të kërkojë dhe marrë në çdo formë financimi nga Institutet Kredidhënëse, bankat, shoqëritë dhe Individët, duke dhënë garanci të përshtatshme reale dhe personale.
- Shoqëria gjithashtu mund të përmbushë të gjitha operacionet tregtare edhe të import – eksportit, industrial, për pasuri të paluajtshme dhe letra me vlerë që gjykohej të jenë të nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e objektit të veprimtarisë dhe mund të mbajë aksione në shoqëri të tjera, të japë kredi, lëshojë garanci dhe garanci të tjera në natyrë, të fitojë dhe cedojë kredi, gjithashtu shoqëria do të jetë përgjegjëse për marrjen e licensave dhe lejeve të nevojshme në të gjitha institucionet publike shqiptare, në përputhje me rregulloret dhe kriteret për zhvillimin e veprimtarisë së vetë shoqërisë.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 5.000.000 Lekë (pesë milion) dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Adrian Masha**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Ervin Çadri**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë dhe (dy milion e pesëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.



## NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Z. Adrian Masha**, shtetas shqiptarë, lindur në Tiranë, më 31/03/1983, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së Identitetit me nr. 034179917 me nr. personal. I30331062D, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, , zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM


Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8 DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Adrian Masha** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKËT THEMELUES

**ADRIAN MASHA**

*Adrian Masha*  


**ERVIN ÇADRI**

*Ervin Çadri*  
